



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI  
ADRESA KAJO KARAFILI  
TEL: 683030361

# MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE E BARRËS SIGURUESE KUOTA/AKSIONË)

Nr. repertori: 1420

Nr. koleksioni: 837

Tirane më 18/03/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053240078784085

\*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



Faint, illegible text located in the upper left quadrant of the page.

Faint, illegible text located in the upper right quadrant of the page.

# STARKO YERUSHALAYI

Faint text line below the main title, possibly a subtitle or address.

Faint text line in the lower middle section, possibly a name or title.

Faint text line in the lower middle section, possibly a name or title.

Faint text line in the lower middle section, possibly a name or title.

Faint text at the bottom left of the page, possibly a date or reference number.

Faint text at the bottom right of the page, possibly a date or reference number.



A2024053240078784085

## MARREVESHJE E BARRES SIGURUESE

Ne Tirane Shqiperi, me date 19/03/2024, perpara meje Ridvane Ruci, Notere ne Dhomen e Notereve Tirane, me zyre te regjistruar ne rrugen Kajo Karafili, Tirane, Shqiperi, u paraqiten palet e meposhtme:

### BANKAT KREDIDHENESE/BARREMARRESIT:

- i. **BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA.**, me adresë të selisë qendrore në Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, hyrja 1, Njësia bashkiake 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shqipëri sipas Vendimit Nr. 20830, datë 12 Shkurt 1999, me NIPT J91725007P, e përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Anila DACI, e identifikuar me Leternjoftimin Nr. 034140475, me Nr. Personal H45220062B, leshuar me 16 Prill 2019, nga MB, Shqiperi dhe Z. Andri DEDA identifikuar me Leternjoftimin Nr. 033276472, me Nr. Personal I61129034K, leshuar me 20 Dhjetor 2016, nga MB, Shqiperi
- ii. **BANKA E TIRANES SHA.**, me adresë të selisë qendrore në Rr. "Ibrahim Rugova", PO BOX 2400/1, Tiranë, Shqipëri; themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT J61924008V, e përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Glenda KURTI, e identifikuar me Leternjoftimin Nr. 034052261, me Nr. Personal H85306150N, leshuar me 21.03.2019, nga MB, Shqiperi dhe Znj. Aida CENGU, mbajtese e Leternjoftimit Nr. 035236532 dhe me Nr. Personal H05216129L, leshuar me 04/12/2019 nga MB, Shqiperi,
- iii. **UNION BANK SHA.**, me adresë të selisë qendrore në Njësine Bashkiake Nr. 9, Sheshi "Ferenc Nopçka", Ndërtesa Nr. 5, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT K51807801R, e përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Znj. Flutura VEIPI, e identifikuar me Pasaporten Nr. BF0267108, me Nr. Personal H75916144N, leshuar me 21.07.2021, nga MPB, Shqipëri dhe nga Drejtori i Divizionit të Kredisë Z. Gent DRITA, mbajtes i Leternjoftimit Nr. 035003868 dhe me Nr. Personal H81008138K, leshuar me 28.10.2019 nga MPB, Shqiperi








(nga i. ne iii. i referohemi ketej e tutje si "Bankat Kredidhenese/Barremarresit");

### BARREDHENESI:

**GENER 2 Shpk**, me qendër në Njesia Administrative Nr. 2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr. 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT K58615301M, perfaqesuar ligjerisht nga Artila Ulaj, e datëlindjes 05.09.1981, shtetase shqiptare, mbajtëse e Leternjoftimit ID Nr. 036435540, Nr. Personal I15205096A, leshuar me date 19.09.2020, sipas Vendimit te Shoqerise Nr. 27, date 13.03 2024 vertetuar me Vertetim Nenshkrimi Nr. 1101 Rep., date 14.03 2024, Noter Sh. Brahaj (bashkengjitur); që këtu e më poshtë do të quhet "Barredhenesi".

### DHENESI I PELQIMIT:

**DRAGOBIA ENERGY SHPK**, me qendër në Tirane Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertese nr. 12, ABA Business Center, Kati i 7 teknik, Kodi Postar 1010, themeluar dhe regjistruar si

4        Fq. 1



A2024053240078784083

person juridik shqiptar me NIPT K92025004T, përfaqësuar ligjërisht nga: Gezim Pani, i datëlindjes 22.08.1978, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr. 033977605, Nr. Personal H80822036L, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë, sipas Vendimit të Shoqërisë Nr. , date 2003 2024 vertetur me Vertetim Nenshkrimi Nr. 1100 Rep., date 1403 2024, Noter Xh. Brokaj (bashkëngjitur); që këtu e më poshtë do të quhet "Dhënesi i Pelqimit".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre unë, Noteri, arrita në përfundimin se ato janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Palet me vullnetin e tyre të lire e të plote bien dakord që të lidhin këte marreveshje Barre Siguruese me kushtet dhe afatet si me poshte vjon:

### Percaktime:

Ne këte marreveshje, përveç kur diktohet ndryshe nga përmbajtja, (1) kjo Marreveshje përfshin ndryshimet apo dokumentat aksesore të kesaj Marreveshje, apo çdo Dokument të Kredise; (2) nenet, seksionet, dhe anekset i referohen neneve, seksioneve dhe anekseve të kesaj Marreveshje;

Ne këte marreveshje kur ne përmbajtjen e njerit prej Neneve apo Paragrafeve të saj është vendosur shenja "xxxx" atehere ai Nen apo Paragraf do të jete i pa aplikueshem dhe nuk do të merret parasysh gjate intepretimimit të kesaj marreveshje pa cenuar vlefshmerine e Neneve ose Paragrafeve të tjere,

Ne këte marreveshje, përveç kur është percaktuar ndryshe:

- 1 fjalet që janë në njejes përfshijne edhe shumetin dhe anasjelltas;
- 2 kredimarres përfshin edhe barredhenes;
- 3 kredimarres përfshin edhe bashkekredimarres, nese ka të tille;

### I. QELLIMI DHE OBJEKTI I MARREVESHJES

1. Kjo Marreveshje shërben si mjet sigurimi për të garantuar Bankat Kredidhenese për shlyerjen e kredise dhe të të gjitha detyrimeve të parashikuara në Shtojce Kontraten Nr.Rep 1414, Nr.Kol 831, date 08/03 2024, noter P.P., "Per Disa Shtesa dhe Ndryshime në Kontraten e Kredise Bankare për Financim të Perbashket Nr.Rep 6098, Nr.Kol 2926, date 14.10.2023, noter Ridvana Ruci" e lidhur midis Bankave Kredidhenese dhe Kredimarresit DRAGOBIA ENERGY SHPK me qëllim akordimin e kredise shtese në shumën **4,000,000 (kater milion) Euro, ose ekuivalenti i kesaj shume në monedhen Leke (ketu e më poshte referuar si Kontrata e Kredise).** Pas disbursimit të limitit shtese të kredise shumata totale/perfundimtare e kredise se akorduar Kredimarresit, e siguruar me këte kolateral, do të rezultojë në shumën 30,000,000 (tridhjetë milion) Euro.

2. Sipas afateve dhe kushteve të kesaj Marreveshje dhe në përputhje me Ligjin nr. 8537, dt. 18/10/1999 "Per barret siguruese" i ndryshuar, Barredhenesi vendos barre siguruese të radhes se dyte në favor të Bankave Kredidhenese mbi kolateralin e pershkruar me poshte:

- a) Barre siguruese mbi 100 (njqind) kuota me vlere 211,220,000 Lek (dyqind e njëmbëdhjete milion e dyqind e njëzet mijë Lek) e zoteruar prej Barredhenesit (shoqëria "Gener 2") në kapitalin e Shoqërisë Koncesionare "Dragobia Energy" Sh.p.k (NUIS K92025004T) (në vijim quajtur "Shoqëria") dhe që përfaqëson 100% (njqind përqind) të kapitalit të kesaj Shoqërie; si dhe
- b) çdo kuota të re të Shoqërisë Koncesionare "Dragobia Energy" Sh.p.k, tituj, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohe dhe në çdo menyre (qofte me ane të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zevendesimit, kembimit) në lidhje me ose mbi cilendo kuota të Shoqërisë që mund të



A2024053240078784085

fitohet ne te ardhmen prej Barredhenesit nepermjet kapitalizimit te fitimeve, rritjes se kapitalit etj.; si dhe

- c) te gjitha te drejtat qe rrjedhin ne menyre direkte ose indirekte nga zoterimi i Kuotes, duke perfshire por duke mos u kufizuar vetem ne te drejten e dividendeve (fitimeve) dhe te drejten e votimit ne asamblene e ortakeve lidhur me Kuoten;
- d) (te cilave bashkerisht (a), (b) dhe (c) tani e tutje do t'i referohemi si "Kolaterali").

Barra siguruese do te regjistrohet ne Regjistrin e Barreve Siguruese dhe Bankat Kredidhenese do te kene kopjen origjinale te vertetimit perkates.

Marreveshja e Barres Siguruese do te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe do te pasqyrohet ne ekstraktin e shoqerise.

## II. DETYRIMET E BARREDHENESIT

3. Ne çdo kohe qe Bankat Kredidhenese konstatojne se vlera e kolateralit eshte zvogeluar ose eshte duke u zvogeluar, si dhe kur Bankat Kredidhenese çmojne se vlera e tij nuk mjafton per te mbuluar detyrimin, Barredhenesi, me kerkesen e Bankave Kredidhenese, detyrohet te jape garanci shtese per te arritur mbulimin e plote te shumes se siguruar nga kolaterali.
4. Barredhenesi nuk do te krijojë ose pranojë venien e ndonjë barre tjetër mbi kolateralin përveç asaj qe eshte objekt i kesaj marreveshje dhe ne favor te ketyre Bankave Kredidhenese. Barredhënësi deklaron, gjithashtu, se kolaterali i barresuar nuk eshte nen ekzekutim te detyrueshem ose ndaj tyre nuk jane vendosur detyrime ose barre, pervec barres ne favor te ketyre Bankave.
5. Barredhenesi nuk ka të drejte te transferoje, të tjetersoje kolateralin e barresuar apo te zvogeloje vleren e tij pa miratimin paraprak me shkrim të Bankave Kredidhenese.
6. Barredhenesi bie dakord qe afati i regjistrimit te kesaj marreveshje ne Regjistrin e Barreve Siguruese do te jete i vlefshem per 25 (njetete e pese) vite nga data e maturimit te kredise, por ne cdo rast jo me shume se afati i parashikuar ne piken 15 te Kreut IV te kesaj kontrate.
7. Gjate kohezgjatjes se kesaj Marreveshje dhe Kontrates se Kredise te permendur me siper, Barredhenesi eshte i detyruar te mirembaje kolataralin me shpenzimet e tij.
8. Barredhenesi do te njoftoje menjehere Bankat Kredidhenese per cdo fakt dhe rrethane qe mund te rrezikojë ekzekutimin e Barres Siguruese.
9. Barredhenesi do te njoftoje menjehere Bankat Kredidhenese, me kerkesen e ketyre te fundit, per gjendjen e kolateralit.
10. Pervec nga sa parashikohet me siper, Barredhenesi nuk do te krijojë ndonjë hipoteke, peng ose barre siguruese mbi mjetet e tij, pa marre me pare miratimin me shkrim nga Bankat Kredidhenese.



A2024053240078784083

11. Kolaterali mund të ndryshohet vetëm me marrveshje me shkrim të nënshkruar nga të gjitha palët në këtë Marrveshje.
12. Në rastet kur Bankat Kredidhenese nisin ekzekutimin e një pjese apo teresise se Kolateralit të përshkruar me sipër, do të aplikohen dispozitat perkatëse të parashikuara në kuadrin ligjor/rregullativ të aplikueshem në fuqi.

### III. EKZEKUTIMI I BARRES SIGURUESE

13. Në rastet kur kolaterali është llogari, instrument, ose titull, dhe Kredimarrësi/Barredhenesi nuk përmbush detyrimet e tij për shlyerjen e Kredise (principalin, interesat etj,) ose kur ndonjë prej Kredive maturohet apo behet menjehere e pagueshme, siç përcaktohet në Kontraten e Kredise:
  - a. Bankat Kredidhenese rezervojnë të drejtën të njoftojë Barredhenesin që t'i paguajë Bankave Kredidhenese shumën e llogarisë, të instrumentit ose titullit, dhe pasi të ketë zbritur shpenzimet e arsyeshme të bëra për arkëtimin, t'i përdorë paratë e arkëtuara për përmbushjen e detyrimit të siguruar nëpërmjet barrës siguroese.
  - b. Barredhenesi autorizon Bankat Kredidhenese që në mënyrë të parëvokueshme dhe pa njoftim paraprak:
    - i. të debitojë (arketojë) llogarinë e kolateralit në çdo kohë dhe për çdo detyrim në vonesë sipas Kontrates së Kredise;
    - ii. të debitojë (arketojë) llogarinë e kolateralit për ripagimin e vlerës totale të Kredise së bashku me interesat dhe kamatë vonesat e llogaritura deri në atë ditë sipas kushteve të Kontrates së Kredise, në rast se Kredimarrësi/Barredhenesi është në vonesë për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë.
14. Në rastet kur kolaterali është një send i luajtshëm, dhe Kredimarrësi/Barredhenesi nuk përmbush detyrimet e tij për shlyerjen e Kredise (principalin, interesat etj,) ose kur ndonjë prej Kredive maturohet apo behet menjehere e pagueshme, siç përcaktohet në Kontraten e Kredise, Bankat Kredidhenese rezervojnë të drejtën:
  - i) të njoftojnë Barredhenesin që t'i dorëzojë kolateralin dhe ta perdorë atë për përmbushjen e detyrimit të siguruar nëpërmjet barrës siguroese. Barredhenesi menjehere pas marrjes së njoftimit nga Bankat Kredidhenese, do të dorëzojë kolateralin me shpenzimet dhe në përgjegjësinë e tij në çdo vend të përcaktuar nga Bankat Kredidhenese, bashkë me dokumentet perkatëse.
  - ii) në rast se Barredhenesi nuk e përmbush detyrimin për të dorëzuar kolateralin sipas njoftimit të Bankave Kredidhenese, Bankat Kredidhenese kanë të drejtë të marrin në posedim kolateralin dhe dokumentet perkatëse nëpërmjet procedurave të ekzekutimit të detyrueshem.

### IV. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

15. Kjo Marrveshje mbetet në fuqi deri sa kredimarrësi i sipërpermendur të shlyejë plotësisht në favor të Bankave Kredidhenese kredite që ka marrë nga Bankat Kredidhenese, së bashku me interesat perkatëse dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas Kontrates së Kredise ekzistuese si dhe ndryshimeve të kësaj kontrate që do të lidhen në të ardhmen ndërmjet



A2024053240078784083

Bankave Kredidhenese dhe kredimarresit te siperpermendur, sic percaktohet ne nenin I.1 te kesaj Marreveshje.

16. Ne rast se Kredimarresi i siperpermendur nuk permbush detyrimet e tij ose nuk ka paraqitur te dhena te sakta, te cilat Bankat Kredidhenese i kane marre si baze per te dhene kredine, ose kur ndodh njeri nga rastet e mospermbushjes, siç percaktohen ne Kontraten perkatese te kredise, Bankat Kredidhenese kane te drejte te zgjidhin Kontraten perkatese te kredise ne menyre te njeanshme dhe te procedojne me mbledhjen e detyrimit.
17. Kjo marreveshje rregullohet dhe zbatohet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe palet ketu pranojne t'i nenshtrohen Juridiksionit te Gjykatave Shqiptare.
18. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marreveshje, Barredhenesi deklaron se i gjithë informacioni që ka dhënë është i saktë dhe i plotë dhe se do të informojë Bankat Kredidhenese për çdo ndryshim në të ardhmen. Barredhenesi konfirmon se ka marrë, ka lexuar, ka kuptuar dhe eshte dakord me termat dhe kushtet e kësaj Marreveshje.
19. Barrdhenesi deklaron se: Në kuptim të parashikimeve të Ligjit nr.9887, dt.10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, jap pëlqimin tim paraprak, që të dhënat e mia personale dhe cdo informacion tjetër qe kam dhene ne lidhje me kete sherbim, Bankat Kredidhenese kane te drejte, ne perputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë, ta perpunojne, ta transmetojne tek persona te lidhur me Bankat, dhe/ose grupit të kompanive të specializuara në administrimin dhe/ose përpunimin e të dhënave personale dhe sensitive të Bankave dhe/ose klientëve të Bankave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si edhe nga palët e treta (duke përfshirë por jo duke u kufizuar në banka korrespondente, operatorët ndërmjetësues që kryejnë shërbime të tilla etj.) si dhe pranë subjekteve partnere/kontraktore. Pranoj që në numrin tim personal të celularit/postën elektronike (e-mail)/ adresën postare të deklaruar prej meje pranë Bankave Kredidhenese me këtë Marreveshje ose më pas nese do te kete ndryshime, te njoftohem nga Bankat Kredidhenese sipas rastit, për çështje që kanë lidhje me marrëdhëniet e mia si Klient me Bankat Kredidhenese.
20. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Bankat Kredidhenese kane marrë të gjitha masat për aplikimin e teknologjive dhe procedurave specifike për ruajtjen e të dhënave personale të klientit. Gjithashtu Bankat Kredidhenese kërkojne nga çdo palë kontraktore e cila përpunon apo ka askes në të dhënat për efekt të operimit të transaksioneve bankare, respektimin e rregullave të sigurisë dhe konfidencialitetit, të cilat janë gjithashtu elemente të vlerësimit gjatë negociatave parakontraktore, si dhe sanksionohen në Marreveshjen që Bankat Kredidhenese nënshkruajne me partnerët e saj të biznesit
21. Kjo Marreveshje eshte titull ekzekutiv.

Kjo Marreveshje eshte pjese perberese dhe e pandare e Kontrates se Kredise Bankare per Financim te Perbashket Nr.Rep 6098, Nr.Kol 2926 date 14.10.2023, noter Ridvana Ruci ndryshuar me Shtojce Kontraten Nr.Rep 414, Nr.Kol 831, date 18/03/2024, noter P. P. S.

Kjo Marreveshje eshte hartuar ne 7 (shtate) kopje identike në gjuhen shqipe.



A2024053240078784085

Unë noterja pasi ua lexova palëve me zë të lartë përmbajtjen e kësaj Marreveshje, konstatova se ajo vjen në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe pasi ata nënshkruan në praninë time, unë noterja vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

**PALET NENSHKRUESE**

**BANKAT KREDIDHËNËSE/BARREMARRESE**

**BARREDHENESI**

**BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA**

Perfaqesuar nga

Anila DACI

Andri DEDA

*Anila Daci Andri Deda*

**GENER 2 SHPK**

Perfaqesuar nga

Artila ULAJ

*Artila Ullaj*



**BANKA E TIRANES SHA**

Perfaqesuar nga

Glenda KURTI

Aida CENGU

*Glenda Kurti Aida Cengu*



**DRAGOBIA ENERGY SHPK**

Perfaqesuar nga

Gezim PANI

*Gezim Pani*



**UNION BANK SHA**

Perfaqesuar nga

Flutura VEIPI

Gent DRITA

*Flutura Veipi Gent Drita*



NOTER \_\_\_\_\_

*[Large signature]*